

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Formulari i njoftimit të fituesit

OPERATORIT EKONOMIK “ERGI”

Autostrada Elbasan –Metalurgji, km.3, lagjia 28 Nëntori, Rajoni nr.3, Elbasan

Procedura e prokurimit: “Ndërhyrje emergjente për stabilizimin e rëshqitjes në km 21+495 ÷21+620, në segmentin Lin – Pogradec.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-14415-03-19-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedura është Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit”, situatë emergjente, parashikuar nga neni 33/2/c, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pikës 2/c neni 36 “Rregullat e prokurimit publik,” të miratuar me VKM-në, Nr.914, datë 29.12.2014, e ndryshuar, sepse ka të bëjë me nevoja ekstreme, sipas kushteve është shkaktuar një ngjarje e paparashikuar, Autoriteti Kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen, Ngjarja demton interesin e përgjithshëm të një komuniteti të gjere, Nuk ka qenë e mundur të ndiqen procedurat standarte mbi ose nën kufirin e ulët monetar. afati i zbatimit të kësaj kontrate emergjente do të jetë 2.5 muaj. “Autoriteti kontraktor ndodhet përballë një situatë emergjente, masat mbrojtëse dhe punimet për stabilizimin e kësaj rreshqitje duhet të behen në kohë të thate dhe shumë shpejt, duke shfrytëzuar sezonin me kohë të mirë (pra stinën e pranverës) pasi në rast të kundërt mund të kemi avancime të metejshme të rreshqitjes e cila do të kërkojë një vlerë shumë më të madhe për eliminimin e pasojave të rreshqitjes si dhe shtyrjen në një kohë më të gjatë të përfundimit të të gjithë punimeve në segmentin rrugor Lin – Pogradec”.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Jo

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “VARAKU E” & “SULOVA NDERTIM PRODHIM”

NUIS: J61902509S / L43027201P

Vlera: 148 794 159 (njëqind e dyzete e tete milion e shtatëqind e netedhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e nete) leke

2. “PE – VLA – KU”

NUIS: K61716013M

Vlera: 171 949 366,94 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e neteqind e dyzete e nete mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje netedhjetë e katër) leke

3. “VELLEZRIT HYSA”

NUIS: K12911201C

Vlera: 206 143 431,29 (dyqind e gjashtë milion e njëqind e dyzete e tre mijë e katërqind e tridhjetë e një, presje njëzete e nete) leke

4. “ERGI”

NUIS: K02727229P

Vlera: 188 156 488 (njëqind e tetëdhjetë e tete milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tete)leke

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. “VARAKU E” & “SULOVA NDERTIM PRODHIM”

NUIS: J61902509S / L43027201P

2. PE – VLA - KU shpk

NUIS: K61716013M

Pikërisht për arsyet e mëposhtme

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “VARAKU E & Sulova Ndertim Prodhim” , është tërhequr nga gara sipas shkresën nr.15 prot i shoqërisë, date 25.03.2019 bere ne sistemin elektronik,.
2. Operatori ekonomik “ PE VLA KU “shpk , nuk ka paraqitur dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e kriterëve te vecanta per kualifikim pasi,
1.1Aksionet e Operatorit “PE VLA KU shpk” , me Urdhrin Nr. 1303 Prot, datë 18.12.2017, "Për Vendosjen e sekuestros konservative",te permbaruesit Gjyqësor Altin Vako , jane nen sekuestro konservative .

KVO sot me datën 25.03.2019 , ben verifikimin ne www.qkb.gov.al , ne ekstraktin historik te PE VLA KU shpk dhe konstaton se urdheri i sipercituar eshte ende ne fuqi dhe aktualisht ne momentin e vleresimit te ofertes nuk eshte hequr sekuestro konservative.

1.2Operatori PE VLA KU shpk ka mosperputhje te drejtuesit ligjor sipas QKR me drejtusin ligjor te licenes ne kundërshtim me percaktimet e pika 2 Kieu I “ VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”.

Sipas QKR se paraqitur drejtues ligjor (*administrator*) I PEVLAKU shpk eshte z Vladimir Pjeter Gjokaj, kurse sipas Licenses NZ 5147/13 drejtues ligjor eshet vetem z Kujtim Arifaj .

1.3. Operatori PE VLA KU shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte per te deshmuar plotesimin e pikës 2.3.7 te kriterëve te vecanta per kualifikim (Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ERGI” shpk , me adrese *Autostrada Elbasan –Metalurgji, km.3, lagjia 28 Nëntori, Rajoni nr.3, Elbasan*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 188 156 488 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 2234789 / +355 4 2223600, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 206 143 431,29 *(dyqind e gjashte milion e njeqind e dyzete e tre mije e katerqind e tridhjetë presje njezete e nente)leke* , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.03.2019